



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

---



**STATUTI**

**I**

**BIBLIOTEKËS KOMUNALE "HIVZI SYLEJMANI"**  
**PRISHTINË**

**Prishtinë, prill 2013**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika a, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/115, qershor 2008), të dispozitave të nenit 18 të Ligjit nr. 04/ L - 097, për bibliotekat, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 9/4, maj 2012) dhe të dispozitave të nenit 34, pika 34.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 11.04.2013, miratoi

## STATUTIN E BIBLIOTEKËS KOMUNALE "HIVZI SYLEJMANI" PRISHTINË

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Qëllimi

##### Neni 1

Më këtë Statut rregullohet statusi i bibliotekës komunale "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: "biblioteka"), veprimtaria e bibliotekës, struktura, organizimi dhe financimi i bibliotekës, planifikimi dhe transparenca.

##### Neni 2

Për realizimin e funksionit dhe detyrave që i takojnë, biblioteka vepron në pajtim me dispozitat e Ligjit për biblioteka, këtë statut dhe vendimet që i miraton Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

### II. STATUSI JURIDIK I BIBLIOTEKËS

##### Neni 3

1. Biblioteka e Prishtinës është themeluar me Vendimin e Këshillit Popullor të Komunës së Prishtinës, nr. 6964, të dt. 26.4.1963.
2. Në pajtim me dispozitat e Ligjit për biblioteka dhe Vendimin 01. nr. 031 - 209, të datës 4.5.2006, për regjistrimin e bibliotekës publike të qytetit të Prishtinës "Hivzi Sylejmani", biblioteka ka vazhduar punën - veprimtarinë e bibliotekës.
3. Sipas dispozitave të nenit 18 të Ligjit për bibliotekat, që është në fuqi, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me 26.2.2013, ka miratuar Vendimin për vazhdimin e punës të bibliotekës komunale "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë, si institucion kulturor dhe arsimor, me detyra dhe përgjegjësi që i takojnë sipas Ligjit për biblioteka.

##### Neni 4

Selia e bibliotekës është në Prishtinë, lagjja "Dardania", rr. "Xhemail Mustafa" p.n. Prishtinë.

##### Neni 5

1. Emërtimi i bibliotekës është: Biblioteka komunale "Hivzi Sylejmani" Prishtinë.

2. Biblioteka ka status të personit juridik, me funksion dhe detyra që i takojnë me ligj, statut dhe vendime të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.
3. Pasuria e bibliotekës është pronë e Komunës.
4. Për qarkullim financiar biblioteka përdor xhirollogarinë e Komunës dhe nën-llogarinë e caktuar nga Komuna.
5. Në hyrje të objektit të bibliotekës dhe të degëve të saja, vendoset mbishkrimi në gjuhët zyrtare, të parapara me Ligjin për përdorim të gjuhëve që është në fuqi.

#### Neni 6

1. Biblioteka ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore.
2. Vula e rrumbullakët është me diametër 2.5 cm dhe ka këtë përmbajtje:
  - a) Rrethi i parë: *Republika e Kosovës*;
  - b) Rrethi i dytë: *Komuna e Prishtinës*;
  - c) Rrethi i tretë: *Biblioteka komunale "Hivzi Sylejmani"*;
  - d) Në mes të vulës është *emblema - libri i hapur*.
3. Vula katrore, e pranimit dhe e dorëzimit, është e madhësisë 6 x 2.5 cm, me këtë përmbajtje:
  - a) *Republika e Kosovës*;
  - b) *Komuna e Prishtinës*;
  - c) *Biblioteka komunale "Hivzi Sylejmani"*;
  - d) *Njësia organizative, numri dhe data*.

### III. FUNKSIONI I BIBLIOTEKËS

#### Neni 7

Në kuadër të bibliotekës zhvillohen këto detyra dhe punë:

- a) nxitja për të mësuarit gjatë gjithë jetës, zgjerimi i dijeve dhe interesimi për lexim për qytetarët e komunës së Prishtinës;
- b) sigurimi i qasjes së lirë në dije e informacion dhe ofrimi i shërbimit të barabartë për të gjithë qytetarët;
- c) grumbullimi, ruajtja dhe propagandimi i kulturës brenda territorit të komunës;
- e) Krijimi i katalogut dhe sigurimi i informacioneve për materialet bibliotekare me karakter historik, kulturor dhe shkencor për territorin e komunës së Prishtinës;
- f) koordinimi dhe mbikëqyrja e punës profesionale të degëve brenda territorit të komunës së Prishtinës, duke ndihmuar në pasurimin e fondeve me koleksione bibliotekare;
- g) bashkëpunimi në përpilimin e katalogut të përbashkët elektronik me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës dhe ofrimi i tij në dispozicion të përdoruesve;
- h) bashkëpunimi me bibliotekat komunale në Kosovë, Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, bibliotekat tjera të themeluara me ligj dhe bibliotekat ndërkombëtare;

- i) organizimi i aktiviteteve kulturore dhe edukative në ambientet e saj, siç janë: ekspozitat e librit, promovimet, tribunat, takimet me krijues, orët letrare dhe veprimtaritë tjera bibliotekare;
- j) bashkëpunimi me institucionet kulturore, shtëpitë botuese, shkollat dhe komunitetin, me qëllim të nxitjes së interesimit për librin dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- k) prezantimi i shërbimeve dhe veprimtarive të saj për publikun përmes ueb - faqes, katalogëve, fletushkave e formave të tjera të informimit;
- l) përpilimi dhe botimi i publikimeve profesionale, si: katalogë, doracakë, fletëpalosje revista etj., në pajtim me Ligjin për biblioteka;
- m) hartimi dhe propozimi i projekteve e programeve për zhvillimin e rrjetit bibliotekar të degëve të cilat i mbikëqyr;
- n) huazimi dhe këmbimi i materialeve bibliotekare, për t'i përmbushur nevojat dhe kërkesat e shfrytëzuesve;
- o) mbledhja e informacioneve dhe materialeve të nevojshme brenda territorit të komunës, të cilat i ruan dhe i ofron në shërbim të përdoruesve;
- p) shfrytëzimi i literaturës së digjitalizuar, bazuar në teknologjinë e hapur;
- q) ushtrimi i veprimtarive të tjera në pajtim me ligj dhe këtë statut.

#### IV. STRUKTURA E BIBLIOTEKËS

##### Neni 8

Strukturat e bibliotekës janë:

- a) drejtori,
- b) Këshilli i bibliotekës dhe
- c) Kolegjiumi profesional.

##### Neni 9

Drejtor i bibliotekës, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj për emërim, duhet të ketë edhe përgatitje superiore profesionale dhe së paku 3 vjet përvojë pune nga fusha e bibliotekarisë.

##### Neni 10

1. Drejtori i bibliotekës, në procedurë të konkursit publik, sipas propozimit të komisionit intervistues dhe mendimit të dhënë nga drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, emërohet me vendim të Kryetarit të Komunës, në kohëzgjatje për periudhën katër (4) vjeçare.
2. Në kushte dhe procedurë të caktuar ligjore, mund të shkarkohet edhe para periudhës për të cilën është emëruar.

##### Neni 11

Drejtori i bibliotekës:

- a) udhëheq, organizon, dhe mbikëqyr funksionimin dhe të drejtat e bibliotekës;
- b) propozon politikat e zhvillimit të bibliotekës dhe politikat për mbështetje financiare;

- c) paraqet raportet përkatëse për rezultatet e punës, ecurinë e shërbimeve dhe përdorimin e buxhetit përmes Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Prishtinës;
- d) organizon, mbikëqyr dhe motivon punën e personelit dhe jep udhëzime dhe urdhëresa për punë;
- e) përcjell problematikën e bibliotekës dhe merr masa për zgjidhje më të mira;
- f) përfaqëson bibliotekën brenda dhe jashtë shtetit;
- g) ushtron edhe detyra të tjera në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet tjera që kanë të bëjnë me bibliotekat.

### Neni 12

#### **Këshilli i bibliotekës**

1. Këshilli i bibliotekës, përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, të cilët duhet t'i përkasin fushës së bibliotekarisë, kulturës ose arsimit.
2. Këshillin e bibliotekës e emëron dhe e shkarkon drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
3. Këshilli i Bibliotekës ka për detyrë të:
  - a) jep këshilla, mendime dhe sugjerime për organizimin, veprimtarinë dhe shërbimet bibliotekare;
  - b) mbron vlerat kulturore, në përputhje me Ligjin për biblioteka, Ligjin për institucionet e kulturës, këtë Statut dhe aktet të tjera;
  - c) shqyrton planin dhe raportin e punës;
  - d) propozon ndryshimet në Statut dhe ndryshime të akteve tjera.
4. Çështjet tjera me rëndësi për Këshillin e bibliotekës do të rregullohen me akt të veçantë.

### Neni 13

#### **Kolegjiumi profesional (KP)**

1. KP-në e përbëjnë anëtarët nga degët ekzistuese të bibliotekës;
2. KP-ja është organ profesional këshillëdhënës i drejtorit të bibliotekës;
3. KP-në e cakton drejtori i Bibliotekës;
4. KP ka për detyrë të:
  - a) jep mendime profesionale lidhur me organizimin e punës dhe kushtet për zhvillimin e veprimtarisë së bibliotekës;
  - b) shqyrton planin vjetor dhe raportin vjetor të punës së bibliotekës;
  - c) jep propozime për aftësimin profesional të punonjësve;
  - d) bashkëvepron në hartimin e punimeve profesionale, të cilat i boton biblioteka.
4. Çështjet tjera me rëndësi për Kolegjiumin profesional të bibliotekës do të rregullohen me akt të veçantë.

## **V. ORGANIZIMI I BRENDSHËM**

### Neni 14

1. Biblioteka veprimtarinë e saj e realizon përmes njërive organizative – sektorëve;

## 2. Sektorët e bibliotekës janë:

- a) Sektori i hulumtimit dhe zhvillimit bibliotekar;
- b) Sektori i pasurimit dhe përpunimit të librit;
- c) Sektori i të rriturve;
- d) Sektori i fëmijëve;
- e) Sektori i periodikut me sallë të leximit;
- f) Sektori i trashëgimisë dhe ruajtjes së librit;
- g) Sektori i punëve të përbashkëta;
- h) Këndi ndërkombëtar;
- i) Info - bibliobusi.

3. Biblioteka në kuadër të saj ka edhe degët brenda territorit të komunës.

4. Biblioteka, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, mund të themelojë sektorë dhe degë të tjera sipas kërkesave, mundësive buxhetore dhe kritereve të përcaktuara me ligj.

5. Me aktin për organizim të brendshëm të bibliotekës, do të rregullohet organizimi, kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive - degëve.

## VI. FINANCIMI I BIBLIOTEKËS

### Neni 15

Mjetet financiare për kryerjen e veprimtarisë së bibliotekës sigurohen nga:

- a) buxheti i Komunës,
- b) të hyrat nga donacionet, fondacionet, OJQ - të e themeluara në Kosovë dhe jashtë saj, shërbimet me pagesë, të cilat do të shfrytëzohen për pasurimin e koleksionit për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e bibliotekës dhe
- c) burimet tjera të parapara me ligj dhe akte të tjera nënligjore.

## VII. PLANI DHE RAPORTI I PUNËS

### Neni 16

Drejtori i bibliotekës përgatit planin e punës dhe raportin e punës. Plani i punës dhe raporti i punës për çdo vit miratohet nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

### Neni 17

Drejtori i bibliotekës planin e punës e harton në pajtim me qëllimet për të cilat është themeluar, vëllimin dhe cilësinë e shërbimeve të kryera nga biblioteka.

### Neni 18

Raporti i punës përmban elementet e një raporti që flet për të arriturat në përmbushjen e objektivave dhe të planit të punës së bërë gjatë një viti.

## VIII. NJOFTIMI I PUNONJËSVE, TRANSPARENCA DHE SEKRETI ZYRTAR

### Njoftimi i punonjësve

#### Neni 19

Njoftimi i punonjësve bëhet:

- a) përmes publikimit të vendimeve të marra në tabelën e shpalljeve të bibliotekës dhe
- b) në bazë të kërkesës së secilit punonjës, në mënyrë që t'i jepen shënimet e kërkuara lidhur me realizimin e të drejtave dhe përgjegjësive të tij.

### Transparenca dhe sekretet zyrtar

#### Neni 20

1. Puna e bibliotekës është transparente për publikun.
2. Transparenca për punën e bibliotekës realizohet përmes:

- a) organizimit të ekspozitave për prezantim;
- b) bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat në lëmin e shkencës, të arsimit, të kulturës dhe
- c) ueb - faqes.

#### Neni 21

Drejtori i bibliotekës është i autorizuar të japë njoftim me shkrim dhe njoftim përmes shtypit, radios dhe TV - së për çështjet që kanë të bëjnë me punën e bibliotekës.

#### Neni 22

Sekret zyrtar në bibliotekë konsiderohet dokumentacioni dhe shënimet, transparenca e të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e bibliotekës dhe të Komunës në përgjithësi. Sekret zyrtar do të trajtohet dokumentacioni dhe shënimet, të cilat janë paraparë me vendim të veçantë të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

## IX. MBROJTJA DHE TË DREJTAT E PUNONJËSVE

#### Neni 23

1. Për realizimin e të drejtave të tyre punonjësit e bibliotekës mund t'i drejtohen drejtorit të bibliotekës, drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Kryetarit të Komunës.
2. Ndaj vendimeve të marra nga drejtorët, mund të ushtrohet ankesë pranë Komisionit të ankesave të Komunës së Prishtinës.

## X. AKTET E BIBLIOTEKËS

#### Neni 24

1. Në bazë të Statutit të miratuar nga Kuvendi i Komunës, biblioteka, përmes Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, miraton rregullore dhe vendime, me të cilat më saktësisht rregullohet veprimtaria e bibliotekës dhe të drejtat e punonjësve të këtij institucioni.

2. Aktet e cekura në pikën 1 të këtij neni, duhet të nxirren në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij statuti.
3. Aktet e miratuara publikohen në tabelën e shpalljeve të bibliotekës.

## **XI. DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE TË HYRJES NË FUQI**

### **Neni 25**

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, pushon të vlej Statuti i miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës 01 nr. 110 - 153, dt. 27.01.2011.

### **Neni 26**

Ky statut hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr. 110-50576, më 11.04.2013**

**KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS**

**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**

